

KONKURSI I PUNIMEVE KËRKIMORE

“Në botën e dijes, ka gjithmonë diçka të re për të mësuar. Ekzistojnë shumë fusha të ndryshme studimesh dhe shkencash që presin të zbulohen. Kërkimi shkencor është një mjet i fuqishëm për të eksploruar dhe për të zgjeruar kufijtë e dijes së njerëzimit.”

Jemi të lumtur t'ju njoftojmë se edicioni i pestë i Konkursit të Punimeve Kërkimore është zyrtarisht i hapur! Qëllimi kryesor i këtij konkursi është të përfshijë studentët në botën e kërkimit shkencor dhe të nxisë përdorimin e bibliotekës "JSTOR" për qëllime hulumtimi përmes shpërblimeve.

Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim, nëpërmjet projektit "CleanScore", ka bërë të mundur qasjen në bibliotekën "JSTOR" për të gjitha universitetet publike partnerë. Mund të gjeni më shumë informacion në faqen zyrtare të "JSTOR" në www.jstor.org.

"JSTOR" është një nga bibliotekat dixhitale më të mëdha që ofron burime të pasur të revistave akademike, librave, dhe materialeve të tjera të rëndësishme për studentët, profesorët, dhe studiuesit në të gjitha fushat e studimit.

Konkursi është i hapur për të gjithë studentët aktualë të universiteteve shqiptare dhe universiteteve të rajonit, përfshirë edhe studentët e alumni që nuk kanë kaluar një vit nga përfundimi i studimeve "Master". Fakultetet dhe universitetet janë të inkurajuar të bashkëpunojnë për të nxitur pjesëmarrjen e studentëve në fushën e kërkimit shkencor.

Çmimet e Konkursit janë si vijon:

1. Çmimi i parë me vlerë \$400
2. Dy çmime të dyta me vlerë \$200 secila
3. Tre çmime të treta me vlerë \$100 secila

Kriteret për pranimin e punimeve janë si vijon:

1. Të përmbahen rregullave të shkrimit akademik;
2. Të përmbajnë të paktën 50% të referencave të marra nga JSTOR;
3. Të përmbajnë midis 2000 dhe 3500 fjalë;
4. Të mos kalojnë 10% të nivelit të plagjiaturës në kontrollin antiplagjiaturë;
5. Të jenë të shkruara në gjuhën angleze;
6. Pjesëmarrësit duhet të jenë studentë në njërin nga programet e studimit “Bachelor” ose “Master”, ose alumni që nuk e kanë kaluar një vit nga përfundimi i studimeve “Master”. Për këtë, punimit të dërguar duhet t’i bashkëngjitet një vërtetim për ndjekjen aktuale të studimeve, ose për përfundimin e tij jo më herët se një vit.

Punimet duhet të dërgohen në adresën e emailit: JSTOR@CleanScore.al deri më datën **1 mars 2024**. Për informacione të mëtejshme, ju ftojmë të vizitoni faqen tonë zyrtare www.cleanscore.al/konkursi.